

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
FUSION INVEST SH.P.K.

Data 01.11.2023

TABELA E LËNDËS

KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
NENI 1.01 PËRKUFIZIME	3
NENI 1.02 THEMELIMI I SHOQËRISË	3
NENI 1.03 OBJEKTI I VEPRIMTARISË	3
NENI 1.04 KOHËZGJATJA	4
NENI 1.05 SELIA	4
NENI 1.06 VULA	4
NENI 1.07 DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE SHOQËRITË E KONTROLLUARA	4
KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR	4
NENI 2.01 VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TË REGJISTRUAR	4
NENI 2.02 ZMADHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR	4
NENI 2.03 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR	5
KREU III. ORTAKU I VETËM	5
NENI 3.01 THIRRJA E ORTAKUT TË VETËM.....	5
NENI 3.02 MBLEDHJET E ORTAKUT TË VETËM.....	5
NENI 3.03 VENDIMMARRJA E ORTAKUT TË VETËM.....	5
KREU IV. ADMINISTRATORI	5
NENI 4.01 EMËRIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORIT.....	5
NENI 4.02 SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET E TJERA	6
KREU V. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR	6
NENI 5.01 DIVIDENDËT	6
NENI 5.02 KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR.....	6
KREU VI. NJOFTIMET	6
NENI 6.01 NJOFTIMET.....	6

KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.01 Përkufizime

Në këtë Statut:

“**Ditë të Plota**” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**” ose “**Ligji**” është ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.

“**Ortaku i Vetëm**” ka kuptimin e ENID Konstruksion sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me NUIS L76507207K, me seli në adresën Rruga Pelivan Leskaj, pallati brenda “Akademisë së Marinës”. Kati i parë, apartamenti 2, përfaqësuar nga administratorja Violeta Idrizaj.

“**Qendra Kombëtare e Biznesit**” ose “**QKB**” ka kuptimin e institucionit sipas ligjit nr.9723 datë 3.5.2007 “*Për regjistrimin e biznesit*” i ndryshuar, si dhe çdo institucion tjetër që në të ardhmen mund të marrë kompetencat e këtij institucioni.

“**Statuti**” ka kuptimin e këtij Statuti.

“**Shoqëria**” ka kuptimin që i jepet te Neni 1.02 (*Themelimi i Shoqërisë*).

Neni 1.02 Themelimi i Shoqërisë

Ortaku i Vetëm themelon shoqërinë Fusion Invest sh.p.k (në vijim “**Shoqëria**”) sot më datë 01.11.2023.

Neni 1.03 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqëria ka për objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve tregtare në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi. Me përcaktim: Zhvillimi i pasurive të paluajtshme, të zoteroje dhe menaxhoje pasuri të paluajtshme e të luajtshme si dhe gjithë të drejtat e tjera shtese që lidhen me këto pasuri. Investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (te prekshme apo te paprekshme. Te kryejë çdo operacioni tregtar, financiar, blerje, shitje ose marrje me qera të objekteve të ndryshme të luajtshme e të paluajtshme apo edhe titujt. Konsulencë financiare, ndërmarrje ndërmjetesimi, imobiliare, në fushën e turizimit, ndërtimit, etj. Blerja, barresimi, hipotekimi apo transferimi të drejtave të pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme si dhe titujve. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë dhe të realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt apo

indirekt, eshte si rrjedhim apo ka te beje me objektivat e renditura me siper. Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter biznesi, i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise. Per te arritur qellimin e mesiper shoqeria mund te ndermarre veprime luajtshme apo te paluajtshme dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, per dhenie me qira apo hipotekim qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet objektivi i shoqerise.

Neni 1.04 Kohëzgjatja

Shoqëria do të operojë pa kohëzgjatje të përcaktuar.

Neni 1.05 Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Emin Duraku, Pallati Binjakët Nr.5, Kati 1 teknik, Ap.1&2, Tiranë.

Neni 1.06 Vula

Shoqëria ka vulën e saj mbi të cilën ka të shkruar emërtimin e saj tregtar.

Neni 1.07 Degët, Zyrat e Përfaqësimit dhe Shoqëritë e Kontrolluara

Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi dhe shoqëri të kontrolluara brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 2.01 Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar

(a) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 1000 (njëmijë) lekë. Kontributi i Ortakut të Vetëm në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

Ortaku: ENID KONSTRUKSION sh.p.k, përfaqësuar nga administratori Violeta Idrizaj

Vlera e kontributit: 1000 (njëmijë) lekë

Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 100% (njëqind për qind)

Numri i kuotave: 1 (një)

(b) Kontributi nga Ortaku i Vetëm do të derdhet në llogarinë bankare të Shoqërisë brenda 1 (një) muaji nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB.

Neni 2.02 Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

(a) Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet nëpërmjet kontributeve në para, kontributeve në natyrë, ose nëpërmjet përfshirjes së rezervave apo fitimit në kapitalin e regjistruar.

(b) Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë:

- (i) duke rritur proporcionalisht vlerën e kuotës së Ortakut të Vetëm në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës;
- (ii) duke pranuar kontribute nga një ortak i ri në Shoqëri.
- (c) Për të dy rastet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, Ortaku i Vetëm miraton zmadhimin e kapitalit me vendim.

Neni 2.03 Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

(a) Ortaku i Vetëm mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë me vendimin e Ortakur të Vetëm.

(b) Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë: duke ulur proporcionalisht vlerën e kuotës së Ortakut të Vetëm në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës.

KREU III. ORTAKU I VETËM

Neni 3.01 Thirrja e Ortakut të Vetëm

Kur Ortaku i Vetëm thirret nga administratori, ai thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (e-mail) drejtuar Ortakut të Vetëm. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i Ortakut të Vetëm, i cili përmban një afat më të shkurtër, është miratuar nga Ortaku i Vetëm. Ortakut të Vetëm, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

Neni 3.02 Mbledhjet e Ortakut të Vetëm

(a) Ortaku i Vetëm thirret me iniciativën e vet si dhe nga administratori, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit.

(b) Administratori kryeson mbledhjen dhe cakton një person për të mbajtur procesverbalin e saj. Nëse administratori mungon, mbledhja kryesohet nga administratori i Ortakut të Vetëm.

Neni 3.03 Vendimmarrja e Ortakut të Vetëm

Ortaku i Vetëm merr çdo vendim në përputhje me Nenin 81 të Ligjit. Çdo vendim tjetër që nuk përfshihet në këtë dispozitë të Ligjit, merret nga administratori.

KREU IV. ADMINISTRATORI

Neni 4.01 Emërimi dhe Shkarkimi i Administratorit

(a) Emërimi dhe shkarkimi i administratorit bëhet nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin. Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë **Z. Devis Bano**, i biri i Thanasit dhe Ermionit i datëlindjes 21.08.1977 mbajtës i pasaportës me nr. BE8719299 dhe nr. personal H70821050R.

(b) Mandati i administratorit do të jetë 5 (pesë) vite duke filluar nga data e emërimit.

(c) Specimeni i nënshkrimit të administratorit paraqitet në Shtojcën 1 të këtij Statuti.

Neni 4.02 Shpërblimi dhe Përfitimet e Tjera

(a) Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Ortaku i Vetëm në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

(b) Ortaku i Vetëm mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në Shoqëri, Shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë Shoqëri të kontrolluara ose për Shoqëri paraardhëse të Shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

KREU V. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR

Neni 5.01 Dividendët

(a) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, Ortaku i Vetëm mund të deklarojë shpërndarjen e dividendit.

(b) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj Shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Neni 5.02 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin e Regjistruar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Ortaku i Vetëm dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të Shoqërisë.

KREU VI. NJOFTIMET

Neni 6.01 Njoftimet

(a) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas Nenit 6.01(c) të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(b) Administratori mund të njoftojë Ortakun e Vetëm personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të Ortakut të Vetëm ose në adresën apo postën elektronike që i është njoftuar administratorit nga Ortaku i Vetëm.

(c) Ortaku i Vetëm do të njoftohet në adresat e mëposhtme: Rruga Emin Duraku, Pallati Binjakët Nr.5, Kati 1 teknik, Ap.1&2, Tiranë;

Ortaku i Vetëm


ENID KONSTRUKSION SH.P.K

Përfaqësuar nga administratori

Violeta Idrizaj



Specimeni i nënshkrimit të administratorit

Devis Bano	
------------	--

